

Njoftim për përqendrim me të cilin AUTO-AS SHPK – SHKUP do të fitojë kontroll mbi INSTITUTIN NDËRTIMOR “MAQEDONIA” SHA, SHKUP.

(lënda nr. 08-176/2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më 04.12.2025, i plotësuar më 17.12.2025, te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin AUTO-AS SHPK – SHKUP, rr. Vostanička 61/17, Shkup do të fitojë kontroll mbi INSTITUTIN NDËRTIMOR “MAQEDONIA” SHA, SHKUP, rr. Drezdenska, Shkup, përmes blerjes së aksioneve.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe veprimtaria e tyre afariste:

AUTO-AS SHPK – SHKUP merret me tregti me shumicë të pjesëve dhe aksesoreve për automjete motorike.

INSTITUTI NDËRTIMOR “MAQEDONIA” SHA, SHKUP ka për objekt veprimtarië – veprimtari inxhinierie dhe këshillim teknik i lidhur.

INSTITUTI NDËRTIMOR “MAQEDONIA” SHA, SHKUP ka persona të lidhur si në vijim:

– Fabrika Karpoš SHA Shkup, e specializuar për sisteme moderne montuese dhe për ndërtim të shpejtë dhe të sigurt.

– GIM Energjetika SHPK Shkup, e cila merret me prodhimin dhe shitjen e energjisë elektrike nga burime të ripërtëritshme.

INSTITUTI NDËRTIMOR “MAQEDONIA” SHA, SHKUP posedon 100% të pjesëmarrjes në Institucionin shkencor privat – Instituti për hulumtime në mjedisin jetësor, ndërtimtari dhe energjetikë.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni ka konstatuar se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje mbetet i rezervuar.

Komisioni i fton palët e treta të interesuara që t’i dorëzojnë vërejtjet dhe mendimet e tyre për këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. “Shën Kirili dhe Metodi” nr. 54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe duhet të arrijnë te Komisioni brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

30.12.2025

Shkup